

## *ABSTRAKT*

### PROCEDURA E TRASHËGIMISË GJYQËSORE DHE NOTERIALE NË KOSOVË

Kandidate: Bleona Smakiqi

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri

Instituti i trashëgimisë përbën një ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës dhe studimi i saj sjell njohuri në nivelin akademik dhe në atë praktik. Në këtë punim do të fokusohemi në aspektet e të drejtës trashëgimore duke shpjeguar shkurtimisht se çfarë trajton kjo e drejtë, elementët e saj thelbësorë dhe rëndësinë që mbart në jetën juridike.

Koncepti i trashëgimisë është universal për të gjitha shoqëritë, pavarësisht nga prejardhja kulturore, historike, ideologjia, feja ose sistemi ligjor. Trashëgimia është një nga mënyrat përmes së cilës fitohet pronësia.

Qëllimi primar i synimit të këtij punimi është shtjellimi i koncepteve teorike mbi trashëgiminë dhe të drejtës trashëgimore, procedurës trashëgimore e zhvilluar në gjykata dhe në zyret noteriale si dhe bartja e trashëgimisë.

Qëllimi sekondar i synimit të këtij punimi është shqyrtimi i ndryshimeve kryesore për procesin e trashëgimisë të cilat janë rezultat i hyrjes në fuqi të Ligji Nr. 06/L-010 Për Noterinë, (Gazeta Zyrtare: 26.12.2018) nr. 23/2018 me anë të cilit barten kompetencat në procedurë jo kontestimore tek noterët për shqyrtim të trashëgimisë si dhe të krahasohet procedura e trashëgimisë në Kosovë me disa nga vendet e rajonit dhe me disa nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE).

Punimi do të analizoj dhe të krijoj një pasqyrë të qartë për rolin e Zyreve Noteriale dhe ndikimin e këtyre zyrave në procedurën trashëgimore në Republikën e Kosovës, ndryshimi në tarifa si dhe kohëzgjatja e procedurave në procesin e trashëgimisë prej hyrjes në fuqi të Ligjit për Noterinë dhe bartjes së kompetencave të gjykatave kompetente tek noterët për shqyrtim të trashëgimisë.

Përmes metodës krahasimore të hulumtimit është arritur tek rezultatet të cilat tregojnë që me fillimin e punës së Zyreve Noteriale ka ndryshimet pozitive sa i përket efikasitetit në e zgjidhjen e çështjeve së trashëgimisë në Republikën e Kosovës.